

Shkëmbim përvojash Shqipëri–Mal i Zi në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), gjatë vizitës zyrtare në Mal të Zi, zhvilloi një takim pune edhe me Drejtorin e Administratës për Burime Njerëzore, z. Agron Camaj, ku u diskutuan praktikat dhe sfidat në menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike.



Biseda u fokusua në proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes së nëpunësve civilë, menaxhimin e karrierës, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional, planifikimin e nevojave për staf, si dhe digjitalizimin e proceseve të burimeve njerëzore.



Gjatë takimit, palët prezantuan strukturat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, si dhe shkëmbyen informacion mbi mekanizmat e administrimit të shërbimit civil dhe politikat për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në administratën publike.

